

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kohavisioni mbetet kanali ku lajmi është përherë i vërtetë
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/kohavisioni-mbetet-kanali-ku-lajmi-eshte-perhere-i-vertete
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:15:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 17:22:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	17cc775eac5685574b79d5d016007d2254855d8c2b1cdf32c2c7d9362bea838b
TEKSTI	999de22a8001c9279ea8651825aa082d2dfd046ed7436e900ae3663c6358feb2
PAMJA	66c8f1421b75ffd68f9618e40bed6f181371a7624b02f2d66c74aea35c87bf2e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8edcb2c69928ada065e9b6e7985f18fe019bf07e2ed40fd36302ac946899d3af
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8edcb2c69928ada065e9b6e7985f18fe019bf07e2ed40fd36302ac946899d3af>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Kohavisioni mbetet kanali ku lajmi është përherë i vërtetë



Nga: Blendina Veliqi

22 shtator 2026 19:22

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanal in tonë zyrtar në Viber

Kohavisioni ka shënuar 26 vjet prej kur për herë të parë filloi transmetimin. Për njerëzit brenda tij, kjo periudhë përfshin vite rritjeje, përvoja dhe kujtimesh të ndërtuara bashkë me televizionin. Ndërkaq, për ata jashtë, KTV-ja mbetet televizioni që për gjithë këto vite u ka qëndruar besnike parimeve profesionale të gazetarisë

26 vjet më parë, kur televizioni në Kosovë po hynte në epokë të re, nisi transmetimin Kohavisioni.

Që nga dita e parë, KTV-ja ka qenë dëshmitare e zhvillimeve më të rëndësishme, por edhe pjesë e historive personale të brezave që janë rritur dhe formuar brenda saj.

“Unë jam rritur personalisht dhe profesionalisht me Kohavisionin duke e ditur se kam ardhur si një vajzë 18-vjeçare dhe tani jam një grua-nënë e tre fëmijëve me një përvojë shumë të madhe në botën e televizionit dhe ndjehem shumë mirë që jam pjesë e KOHËS”, ka thënë Edona Bekteshi-Shala, zëvendësprodhente në Kohavision.

Kujtimet e lidhura me KTV-në i ka ndarë edhe udhëheqësi i montazhit, Azdren Caka

“Më kujtohet kur erdha si 22-vjeçar, të gjithë punëtorët ishin më të moshuar se unë dhe e zura, si të them, ekipin që ka qenë prej fillimit me KTV-në, unë isha më i riu, pak e kisha problem me u ambientu, por më pritën shumë mirë”, ka thënë ai.

Nga dita e parë e transmetimit e deri më sot, KTV-ja ka përcjellë zhvillimet më të rëndësishme, nga ngjarjet politike e shoqërore, e deri te momentet që kanë shënuar historinë e Kosovës.

Edhe



Arbëri • 13 s. më parë

Rexhepi: KTV-ja ka zgjedhur besueshmërinë dhe standardin para pëlqimeve në rrjetet sociale

Arbëri.

Kallas takon Kurtin e Vuçiqin: Koha për të ecur përpara

Arbëri.

Haradinaj: Këto protesta kaq të qeta po më frikësojnë, revolta po mbledhet

Arbëri.

Haradinaj: Behajdin Allaqi u përmend për të krijuar huti dhe përçarje

Kulturë.

Enver Petrovci – artisti që largohet nga jeta, por jo edhe nga skena

Arbëri.

Arrestohet në Maqedoninë e Veriut ish-luftëtari i UÇK-së, Fadil Pushkolli

Futboll.

Kosova vazhdon përgatitjet për duelin ndaj Irlandës

Dren Gërguri ka qenë gazetar në KTV, e tash është profesor në Degën e Gazetarisë në UP. Ai thotë se rëndësia e një mediumi matet edhe me aftësinë për t'i qëndruar besnik profesionalizmit, pavarësisht ndryshimeve që sjell koha.

“Është shumë e rëndësishme dhe shumë e nevojshme për ambientin tonë informativ dhe për ekosistemin tonë të Kosovës që të kemi sa më shumë media të tilla të cilat vazhdojnë të ruajnë standardet profesionale dhe të mos heqin dorë nga ato të cilat mund të jenë edhe nga teknologjia edhe nga çkado tjetër”, ka thënë Gërguri.

Edhe drejtoresha e Asociacionit të Mediave të Pavarura Elektronike në Kosovë, Ardita Zejnullahu, ka thënë se KTV-ja ka ruajtur identitetin e saj profesional gjatë gjithë këtyre viteve.

“KTV ka dëshmuar ndër vite se investimi në gazetari profesionale, përkushtimi ndaj publikut dhe ruajtja e standardeve mediale janë themeli i suksesit afatgjatë. Përballë ndryshimeve të vazhdueshme, sfidave ekonomike dhe ndikimeve të ndryshme, KTV ka arritur të ruajë identitetin dhe rolin e saj në skenën mediale të Kosovës”, është shprehur ajo

Në një kohë kur teknologjia ka ndryshuar mënyrën e prodhimit dhe konsumimit të informacionit, e kur sensacioni është bërë pjesë e garës mediale, sfida për të ruajtur standardet profesionale mbetet e njëjtë: të informosh saktë, paanshëm dhe me përgjegjësi.

Edhe



Arbëri • 19 o. më parë
KTV-ja i mbush 26 vjet

Kryeredaktorja e KOHËS, Brikenda Rexhepi, ka thënë se Kohavisioni tash e 26 vjet i ruan standardet dhe parimet e gazetarisë, edhe përballë një trendi ku shikueshmëria dhe numri i pëlqimeve lidhen gjithnjë e më shumë me të hyrat e mediave.

Rexhepi ka thënë se pëlqimet dhe shikimet në rrjetet sociale, në rastin e prodhimit të lajmeve, në KTV i shohin më shumë si besim sesa si numra.

“Kjo është mbase ajo shtysa që na bën ne të ndihemi mirë dhe të vazhdojmë t'i përcjellim këto parime që i kemi”, ka thënë ajo në emisionin “tre8tre” të KTV-së të hënën.

Rexhepi ka thënë se KTV-ja e ka mundësinë t'i ndjekë këto standarde dhe t'i konfirmojë e rikonfirmojë informacionet para publikimit, ndonëse sipas saj, sigurimi i të hyrave është më i vështirë në një kohë kur ekziston një trend për të pasur sa më shumë shikueshmëri në mënyrë që të ketë sa më shumë të hyra.

Edhe



Arbëri • 31 dhj 2025
“Gëzuar me KOHËN!” për festë e traditë

“Kur punon në media duhet të zgjedhësh nëse dëshiron ta mbash standardin dhe të mos e kesh të gjithë atë ‘reach’ siç e kanë disa media të tjera që kanë edhe të hyra më të mëdha nga kjo fushë, apo dëshiron ta kesh besimin”, ka deklaruar Rexhepi.

KOHA është media më e madhe në vend që i kultivon gazetarinë e pavarur dhe lirinë e shprehjes. KTV-ja mbetet kanali ku lajmi është përherë i vërtetë.

#KTV

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 18 o. më parë
Rrugëtimi 11-vjeçar i montazherit Azdren Caka në Kohavision



SOT • 7 gus 2026

Grupi KOHA dhe “DokuFest”, një çerekshekull rrugëtim bashkë

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.